

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Sherbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Loti XXI: Supervizion punimesh ne objektin „Ndertim mur mbajtes ne rrugen Zagore Goraj“
KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):71247000-1

VLERA E FONDIT LIMIT:

166 481 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë e një)lekë pa tvsh.Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Malesi e Madhe ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti Ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:
Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit dhe kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a) Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit (2023 - 2024 - 2025) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet qe te tregojne raportet midis aktivitetit dhe pasivit . Shenim: Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nese dy bilance te njepasnjeshe nuk kane raport negativ ndermjet aktivitetit dhe pasivit..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", etj.

- b) Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023 - 2024 - 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet. .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u bazuar në Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme ofertuesi duhet të dorezojë:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme, OE duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes deklaruar në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 20 % të vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet për shërbime të ngjashme të kryera në 3 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe 2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për Mbikqyrje dhe

Kolaudim te Punimeve te Zbatimit (leshuar nga Ministria perkatese, sipas legjislacionit ne fuqi) me kategorite e meposhtme:

Kategoria NP-4

Kategoria NP-1

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë perkatese sipas legjislacionit ne fuqi, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, vkm nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, "për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" si dhe pika 4, neni 41 I VKM 285/2021. Kategoritë janë kërkuar bazuar ne preventivin e punimeve te objektit qe do te mbikeqyret dhe konkretisht :

Nr.	Kategoria e lic.	Zerat ne preventiv
2	NP- 4	Sipas llojit te objektit- Rrugë , autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
2	NP – 1	Zeri nr.1

2.3.3. Ofertuesi duhet te kete drejtues teknik ne licencen profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për Mbikqyrje dhe Kolaudim te Punimeve te Zbatimit, te pakten:

a. 1 (nje) Ing. Ndertimi

Per kete, ofertuesi duhet te paraqese kontraten e punes, diplomen/licence dhe CV.

Argumentimi: : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikes 4, neni 41 I VKM 285/2021. Drejtuesit teknike te kerkuar ne piken 2.3.3. kerkohen ne perputhje me kategorite e licencave te kerkuara ne piken 2.3.2.

2.3.4.Një punësim mesatar i të paktën 2 (dy) personave, për periudhën e fundit objekt deklarimi të vërtetuar me:

-Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve per periudhen perkatese;

-Listë pagesat e punonjesve për periudhën perkatese te konfirmuar nga Administrata Tatimore (ne forme elektronike);

(Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te paraqese perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit dokumentin e deklaruar si më lart).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit,

Në përcaktimin e numrit te punonjësve specialisti i fushës ka llogaritur dy inxhinieret qe kerkohen ne piken 2.3.3 si dhe 2 ndihmes sipas rastit.

2.3.5. Operatorët ekonomik duhet të disponojnë certifikatat:

ISO 9001: 2015 “Per menaxhimin e cilesise”

ISO 45001-2023“Sistemet e menaxhimit te sigurise dhe shendetit ne pune”.

Certifikatat duhet të jënë në përputhje me natyrën e objektit që tenderohen dhe të jënë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në emër të ofertuesit.

Në rast bashkimi operatorësh, kjo certifikata duhet të ketë secili operator ekonomik në bazë të përqindjes së punimeve sipas marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.6. Operatori ekonomik ofertues në përlogaritjen e ofertës duhet të referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”

Argumentimi: : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në njoftimin Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik “Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.